

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ushqimet mbajnë gjallë industrinë, nafta dhe kromi në rënie gjatë 2025
ADRESA	https://dosja.al/bota/ushqimet-mbajne-gjalle-industrine-nafta-dhe-kromi-ne-renie-gjate-2025-i516618
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 05:41:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 05:28:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e57aee5f74bbf2195807e5b8a34f02ac1a1bf56e69d7e47e7ce2a773f08188ed
TEKSTI	c492f9661b4a45d3b21e7fba7a60b0c9957f5225cda537a12a07290eff131e60
PAMJA	e05a5f1ca62465fc02ffd4032425a5d126cded9ca65a207f85546caf3ba7424f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f60a0efa1f04edb2e7caf84e2df516986127226cc9d66f33a755a03cbde8ce49
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5eafe312c168c8cb7947308588661084dd025e8060ada60f7d94b18122ee4218
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f60a0efa1f04edb2e7caf84e2df516986127226cc9d66f33a755a03cbde8ce49

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

11 ORE ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit mesazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

11 ORE ME PARE

Debate për territorialien te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

17 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

19 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
balltë, do jetë dështim

Bota

Ushqimet mbajnë gjallë industrinë, nafta dhe kromi në rënie gjatë 2025

Rritja e prodhimit të çimentos, betonit, kabllave elektrike dhe produkteve ushqimore u shoqërua me një rënie të ndjeshme të vlerës së shitjeve të naftës bruto dhe xeherorëve të kromit.



29 Shtator 2026, 07:28
Nga E. D



foto ilustruese

TIRANË- Industria shqiptare shënoi rritje në prodhimin e disa prej produkteve kryesore gjatë vitit 2025, por rezultatet e Anketës së Produkteve Industriale (PRODCOM) të INSTAT tregojnë një tablo të ndryshme për vlerën e shitjeve, veçanërisht në sektorët nxjerrës. Rritja e prodhimit të çimentos, betonit, kabllave elektrike dhe produkteve ushqimore u shoqërua me një rënie të ndjeshme të vlerës së shitjeve të naftës bruto dhe xeherorëve të kromit.

Prodhimi i çimentos Portland arriti në 1.99 milionë tonë në vitin 2025, duke u rritur me 2.5% krahasuar me një vit më parë. Edhe prodhimi i betonit të gatshëm u zgjerua me 3.5%, në 1.77 milionë tonë. Një tjetër industri me rritje të dukshme ishte ajo e sistemeve të fijeve elektrike të izoluar për automjete, prodhimi i të cilave arriti në rreth 263 milionë copë, 8.7% më shumë se në vitin 2024.

Rritje të konsiderueshme u regjistrua edhe në industrinë ushqimore. Prodhimi i bukës së freskët arriti në 67.2 mijë tonë, me një rritje prej 8.4%, ndërsa prodhimi i sallameve dhe produkteve të ngjashme me mish u rrit në 13.3 mijë tonë. Prodhimi i ujit mineral dhe ujit të gazuar u zgjerua gjithashtu, nga 4.98 milionë hektolitra në vitin 2024 në 5.09 milionë hektolitra në vitin 2025.

Megjithatë, rritja e prodhimit fizik nuk është përkthyer në mënyrë të njëjrtshme në rritje të vlerës së shitjeve. Rasti më i dukshëm është nafta bruto. Prodhimi ra në 634.3 mijë tonë në 2025, ndërsa vlera e shitjeve u tkurr nga 29.9 miliardë lekë në 22.6 miliardë lekë. Në terma vjetorë, kjo përfaqëson një rënie prej 24.3% të vlerës së shitjeve.

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një
konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 21:38

VIDEO/ As Ulsi Manja nuk u
shpëton protestuesve,
aktivistja e 'pret' tek dera e
Kuvendit: O hajdut

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51

Reforma territoriale/ Këshilli
Bashkiak i Belshit voton
kundër bashkimit me
Elbasanin, socialistët
abstenojnë

Të njëjtin drejtim mori edhe industria e kromit. Prodhimi i xehedorëve dhe koncentrateve të kromit zbriti nga 588 mijë tonë në 502.8 mijë tonë në 2025, ndërsa vlera e shitjeve ra nga 14.9 miliardë në 11.35 miliardë lekë, ose 23.9% më pak se një vit më parë.

Në krahun tjetër, disa produkte të industrisë përpunuese dhe të ndërtimit kanë shënuar rritje të vlerës së shitjeve. Rritja më e madhe ndër produktet kryesore është regjistruar për llaçin e prodhuar në fabrikë, me 19.5%, dhe aluminin e lidhur të përpunuar, me 15.4%. Shitjet e ujit mineral dhe ujit të gazuar u rritën me 8%, ndërsa ato të bukës së freskët me 11.1%.

Të dhënat e INSTAT tregojnë gjithashtu se struktura e industrisë shqiptare po mbështetet gjithnjë e më shumë te aktivitetet përpunuese. Prodhimi i produkteve ushqimore përbën 16.4% të vlerës totale të shitjeve të produkteve industriale, duke zënë peshën më të madhe ndër aktivitetet industriale. Pas tij renditet prodhimi i produkteve minerare jo metalike me 14.4%, ndërsa metalurgjia zë 8.4%.

Në vlerë absolute, nafta bruto vijon të jetë ndër produktet me vlerën më të madhe të shitjeve, me 22.65 miliardë lekë në vitin 2025, por distanca me produktet e tjera është ngushtuar për shkak të rënies së saj. Çimentoja Portland gjeneroi 19.37 miliardë lekë shitje, betoni i gatshëm 13.67 miliardë lekë, ndërsa xehedorët dhe koncentratet e kromit 11.35 miliardë lekë. Sistemet e fijeve elektrike për automjete arritën në 9.55 miliardë lekë, ndërsa uji mineral dhe i gazuar në 8.96 miliardë lekë./Monitor

Sondazh

Poll

Bota

28 Shtator 2026, 22:58

Netanyahu viziton Emiratet, Abu Dhabi konfirmon takimin me presidentin al-Nahyan

Sheikh Mohamed bin Zayed al-Nahyan DUBAI- Presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Mohamed bin Zayed al-Nahyan dhe kryeministri izraelit Benj...

Kaja Kallas: Tallja e Rusisë me takimin në OKB tregon se s'i intereson t'i japë fund luftës në Ukrainë

Bota

28 Shtator 2026, 22:27

"Kujdes"! Alarm për WhatsApp-in, AKSK paralajmëron për kompromentim llogarish dhe apelon për kujdes të shtuar

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidate

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow

Beta

28 Shtator 2026, 21:56

Grabitje spektakolare përmes AI/ Mashtrulesit marrin rreth 100 milionë euro nga Intesa Sanpaolo

Beta

28 Shtator 2026, 20:17

Analiza: Çfarë i karakterizoi 14 vitet e Vuçiç në pushtet?

Beta

28 Shtator 2026, 20:10

Beta

28 Shtator 2026, 19:45

"Moska po përpiqet të krijojë pasiguri"/ Komandanti i NATO-s: Rusia synon të dobësojë vullnetin e aleatëve për të mbështetur Ukrainën

Alexis Grinkevich RUSI- Rusia po përdor një sërë veprimesh
hibride me synimin për të dobësuar vendosmërinë e ...

Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios për çështjet problematike

Beta

28 Shtator 2026, 17:57

Kongresistë republikanë kërkojnë të mos i zgjatet licenca Industrisë së Naftës së Serbisë

Beta

28 Shtator 2026, 17:55

Kërkoi masa kundër Ebolës, politikani në Kongo rrihet për vdekje dhe i digjet shtëpia

Bota

28 Shtator 2020, 17:20

Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike

Bota

28 Shtator 2020, 17:03

MË SHUMË



Emiriona Sako: Kompetencat e centralizuara të rishikohen dhe të kthehen te bashkia



Emiriona Sako:
Kompetencat e centralizuara të rishikohen dhe të kthehen te bashkia

Debate të "Ligjet"/ Korreshi:
Ky po tall by***n, po e bëni për të grumbulluar votat e PS

Me flakadanë në duar,
protestuesit marshojnë nëpër rrugët e Tiranës, thirrje njëzëri kundër qeverisë

Dita e 121-të e protestës,
qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MBUNDËSHKAR NGA MediasDesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.